

VENDIM
Nr. 472, datë 30.5.2013

**PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË PRONËSISË SË DISA PARCELAVE NDËRTIMORE NË
FAVOR TË POSEDUESVE TË OBJEKTEVE INFORMALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, të shkronjës "ç" të nenit 4 të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e trojeve", të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të nenit 175 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalimit në pronësi të poseduesve të objekteve informale të sipërfaqeve të parcelave ndërtimore sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për:

a) Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana (1), 53 (pesëdhjetë e tre) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 14 546,7 (katërmëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet e gjashtë presje shtatë) m²;

b) Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana (3), 1 (një) parcelë ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 65,1 (gjashtëdhjetë e pesë presje një) m²;

c) Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana (2), 1 (një) parcelë ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 555 (pesëqind e pesëdhjetë e pesë) m²;

ç) Drejtorinë e ALUIZNI-t Kavajë, 8 (tetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 3 341 (tre mijë e treqind e dyzet e një) m²;

d) Drejtorinë e ALUIZNI-t Durrës, 7 (shtatë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 1 388 (një mijë e treqind e tetëdhjetë e tetë) m²;

dh) Drejtorinë e ALUIZNI-t Vlorë (1), 46 (dyzet e gjashtë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 10 014,6 (dhjetë mijë e katërmëdhjetë presje gjashtë) m²;

e) Drejtorinë e ALUIZNI-t Shkodër, 38 (tridhjetë e tetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 9 349,59 (nëntë mijë e treqind e dyzet e nëntë presje pesëdhjetë e nëntë) m²;

ë) Drejtorinë e ALUIZNI-t Fier (2), 34 (tridhjetë e katër) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 11 758,3 (njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë presje tre) m²;

f) Drejtorinë e ALUIZNI-t Lushnjë, 19 (nëntëmbëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 5 137,7 (pesë mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë presje shtatë) m²;

g) Drejtorinë e ALUIZNI-t Elbasan (1), 14 (katërmëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 1 652 (një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy) m²;

gj) Drejtorinë e ALUIZNI-t Elbasan (2), 97 (nëntëdhjetë e shtatë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 16 209,86 (gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntë presje tetëdhjetë e gjashtë) m²;

h) Drejtorinë e ALUIZNI-t Dibër, 12 (dymbëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 2 351,2 (dy mijë e treqind e pesëdhjetë e një presje dy) m²;

i) Drejtorinë e ALUIZNI-t Gjirokastrë, 13 (trembëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 4 731,3 (katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e një presje tre) m²;

j) Drejtorinë e ALUIZNI-t Korçë, 46 (dyzet e gjashtë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 8 076,65 (tetë mijë e shtatëdhjetë e gjashtë presje gjashtëdhjetë e pesë) m²;

k) Drejtorinë e ALUIZNI-t Pogradec, 16 (gjashtëmbëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 3 324,71 (tre mijë e treqind e njëzet e katër presje shtatëdhjetë e një) m²;

l) Drejtorinë e ALUIZNI-t Krujë, 56 (pesëdhjetë e gjashtë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 15 091 (pesëmbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e një) m²;

ll) Drejtorinë e ALUIZNI-t Kukës, 25 (njëzet e pesë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 10 219,51 (dhjetë mijë e dyqind e nëntëmbëdhjetë presje pesëdhjetë e një) m².

2. Ngarkohet Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale për kryerjen e procedurave të kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore të objekteve informale nga shteti te poseduesi i ndërtimit pa leje.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha